



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:280791

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05515922

PPP.nr.237/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh.A, me seli në Prishtinë, rr “Hazir Shala”, nr.4, kundër debitorit M.Sh. nga fsh ..., Komuna e Shtimes, për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 28.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.PRANOHET pjesërisht prapësimi i debitorit M.Sh., i ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbartimit P.nr.765/22, i datës 30.11.2022, i lëshuar nga përmbartuesi privat I.M., sa i përket shumës së borxhit prej 834.24 euro që rrjedh për periudhën kohore nga data 30.11.2021 e deri më datën 30.11.2022 dhe **SHFUQZOHET** urdhri për përmbartim sa i përket shumës së borxhit prej 834.24 euro, për shkak të parashkrimit.

II.REFUZOHET prapësimi i debitorit M.Sh., i ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbartimit P.nr.765/22, të datës 30.11.2022, sa i përket shumës së borxhit prej 73.48 euro që rrjedh për periudhën kohore nga data 01.01.2013 deri më 31.10.2021 dhe për shpenzimet e përmbartimit dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbartimit për shumën e borxhit prej 73.48 euro dhe për shpenzimet e përmbartimit.

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.765/22, të datës 30.11.2022, përmbaruesi privat I.M., e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga kreditori Kompania Rajonale Ujësjellësi “Prishtina” Sh.A, kundër debitorit M.Sh., për pagesën e shumës së borxhit prej 907.72 euro, në bazë të ekstraktit të verifikuar të librave afariste të kontabilitetit, me numër ..., si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbarimore, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe nga xhirollogaria e debitorit të barten në xhirollogarinë bankare të përmbaruesit privat ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar.

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim P.nr.766/22, i datës 30.11.2022.

Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim P.nr.766/22, të datës 30.11.2022 dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, përkatësisht është i bazuar sa i përket shumës së borxhit prej 834.24 euro, për shkak të parashkrimit, kurse nuk është i bazuar sa i përket shumës së borxhit prej 73.48 euro dhe për shpenzimet e përmbarimit.

Gjykata me rastin e rishikimit të procedurës së përmbarimit në bazë të nenit 43, të LPP-së, vlerëson se urdhri i atakuar me prapësim, i lëshuar në këtë rast nga përmbaruesi privat I.M., është pjesërisht i ligjshëm, përkatësisht është i ligjshëm vetëm sa i përket shumës së borxhit prej 73.48 euro dhe për shpenzimet e përmbarimit, mirëpo nuk është i ligjshëm sa i përket shumës së borxhit prej 834.24 euro, për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit nga neni 360, par 1, nën par 1.1, të LMD-së.

Sa i përket pretendimit të debitorit në prapësim se: kjo shumë që kërkohet nga kreditori nuk përkon me gjendjen faktike sepse unë debitori gjithnjë i jam përmbajtur faturave të pagesës, kjo vërtetohet nga kartela financiare e konsumatorit, unë veq tri vite jam duke jetuar në Ferizaj dhe vetëm gjatë verës një kohë e kaloj në vendlindje por se këto shpenzime nuk janë bërë në asnjë mënyrë. Në ndërkohë vërtetova se ujëmatësi ishte prishur, për këtë punëtorët e

kreditorit në Shtime me sugjeruan që të bëjë ndërrimin e ujëmatësit, Gjykata këtë pretendim të debitorit e konsideron të pabazuar dhe të paqëndrueshëm sepse gjatë vendosjes lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin për përmbarim, Gjykata nuk ka tagër dhe kompetencë të bëjë hetim të fakteve apo të vërtetoj një gjendje tjetër të gjendjes faktike nga ajo që ekziston në ekstraktin e verifikuar nga librat afariste të kreditorit në këtë rast, sepse një gjë e tillë mund të bëhet vetëm në procedurën kontestimore të iniciuar sipas padisë nga palët. Po ashtu, Gjykata, në këtë rast ka për detyrë dhe kompetencë vetëm ta bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së urdhrin të atakuar me prapësim.

Kurse sa i përket pretendimit të debitorit se në rastin konkret kanë kaluar mbi 8 vite, pra kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës në të holla, Gjykata edhe këtë pretendim e konsideron si pjesërisht të bazuar ngase me nenin 360, paragrafi 1, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve thuhet : *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*, andaj, Gjykata me rastin e shikimit të ekstraktit të bashkangjitur propozimit për përmbarim nga kreditori, konstatoj se faturat nga data 01.01.2013, deri më 31.10.2021, janë fatura që janë parashkruar konform nenit 360, par 1, të LMD-së, pasi që në dispozitën e këtij neni është paraparë që faturat në fjalë parashkruhen për një vit. Ndërsa faturat nga data 30.11.2021 e deri më datë 30.11.2022, që kapin shumën e borxhit prej 73.48 euro, të njëjtat nuk janë parashkruar, ngase kreditori propozimin për përmbarim e ka ushtruar brenda kësaj periudhe kohore, përkatësisht brenda periudhës një vjeçare.

Si përfundim, Gjykata, duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim, thëniet e kreditorit në përgjigjen në prapësimin e debitorit, si dhe duke i marr parasysh provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, përkatësisht është i bazuar sa i përket shumës së borxhit prej 834.24 euro dhe e shfuqizoj urdhrin për përmbarim sa i përket kësaj shume, për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit, kurse e refuzoj prapësimin e debitorit në pjesën që ka të bëjë me shumën e borxhit prej 73.48 euro dhe për këtë shumë të borxhit vendosi që të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim P.nr.765/22, i datës 30.11.2022.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 4 dhe 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, dhe nenit 360, par 1, nën par 1.1, të LMD-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.237/22, më datë 28.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.